

## INFORMATIV MBI TRAJTIMIN E TE DHENAVE PERSONALE TE PACIENTIT ME NEVOJA PERKTHIMI GJUHESOR

(art. 13 Reg. UE 679/2016)

### Informativ i shkurtër



<b>Kush mund të trajtoj të dhënat e mia</b>
Mbajtësi i të dhënave është : Istituti Romanjol per Studimin e Tumoreve "Dino Amadori" IRST SH.P.K.
Adresa legale: Meldola (FC) via Piero Maroncelli, 40
E mail: <a href="mailto:direzione.generale@irst.emr.it">direzione.generale@irst.emr.it</a> / PEC: <a href="mailto:direzione.generale@irst.legalmail.it">direzione.generale@irst.legalmail.it</a>
<b>Si mund të lidhem me përgjegjësën për mbrojtjen e të dhënave?</b>
Kontakti për <i>Data Protection Officer</i> (DPO): <a href="mailto:privacy@irst.emr.it">privacy@irst.emr.it</a>

Cili është qëllimi i IRST në trajtimin e të dhënave të mia?	Përse trajtimi i të dhënave të mia është i ligjshëm?	Kujt do ti përcillen të dhënat e mia ?	Për sa kohë do të ruhen të dhënat e mia?
<ul style="list-style-type: none"> <li>trajtimi i të dhënave ju lejon të kuptoni informacionet në lidhje me vizitën shëndetsore që keni bërë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>sepse është i domosdoshëm për zbatimin e detyrës publike dhe për arsye me interes publik në sektorin e shëndetësisë publike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zyrave që ofrojnë përkthime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>për sa kohë do të jetë e nevojshme për përmbyshjen e qëllimit për të cilin përdoren (afati kohor për eliminimin i referohet afatit maksimal)</li> </ul>
<b>Çfarë ndodh nëse nuk jap të dhënat e mia?</b>	Mund të verifikohen vështirësi serioze në dhënien e asistencës shëndetsore përveç shërbimeve urgjente të garantuara me ligj.		

<b>Cilat janë të drejtat e mia?</b>	Keni të drejtë •të futeni tek të dhënat e juaja• ti korigjoni dhe në raste të veçanta ti eliminoni . kufizoni përdorimin•kundërshtoni përdorimin. Mund të ushtroni të drejtat tuaja duke dërguar një e-mail tek: <a href="mailto:privacy@irst.emr.it">privacy@irst.emr.it</a>
<b>Kujt mund ti prezantoj ankesë ?</b>	Nëse mendoni që të drejtat tuaja janë dhunuar keni të drejtë të paraqisni ankesë tek Autoriteti Garant për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet udhëzimit që gjeni tek faqja <a href="http://www.garanteprivacy.it">www.garanteprivacy.it</a> .

## Informativ e shtjelluar



### 1. KUSH TRAJTON TË DHËNAT E MIA ?

Përdoruesi i të dhënave tuaja është Instituti Shkencor Romagnolo për Studimin dhe Mjekimin e Tumoreve me qendër legale në Meldola (FC) via Piero Maroncelli, 40. Mund të lidheni me Titullarin :

- me e-mail në adresën [direzione.generale@irst.emr.it](mailto:direzione.generale@irst.emr.it)
- me PEC në adresën [direzione.generale@irst.legalmail.it](mailto:direzione.generale@irst.legalmail.it)

### 2. SI MUND TË LIDHEM ME PËRGJEGJËSIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE TË MIA (DATA PROTECTION OFFICER – DPO)?

Kontaktet për DPO:

- me PEC all'indirizzo [privacy@irst.legalmail.it](mailto:privacy@irst.legalmail.it)
- me e-mail all'indirizzo [privacy@irst.emr.it](mailto:privacy@irst.emr.it)

### 3. PËR CILAT QËLLIME TRAJTOHEN TË DHËNAT E MIA E PËRSE TRAJTIMI ËSHTË I LIGJSHËM?

Të dhënat tuaja trajtohen vetëm për qëllime të lidhura ngushtë me mbrojtjen e shëndetit Tuaj, veçanërisht për t'ju mundësuar sa më mirë kuptimin e informacioneve që kanë të bëjnë me shërbimin shëndetsor të cilit i jeni nënshtruar. Trajtimi i të dhënave tuaja është i ligjshëm edhe pa lejen tuaj sepse është i domosdoshëm për kryerjen e një akti me interes publik e për arsye interesi publik ne sektorin e shëndetësisë publike.

### 4. KUJT I PËRCILLEN TË DHËNAT E MIA ?

Të dhënat tuaja mund ti përcillen institucioneve( organizata, shoqëri, koperativa) që ofrojnë përktitime. Mund të kërkonti një listë ku gjenden të gjithë marrësit e të dhënave tuaja duke shkruar një e-mail tek: [privacy@irst.emr.it](mailto:privacy@irst.emr.it). Në çfarëdo rasti të dhënat tuaja nuk do të shpërndahen.

### 5. TË DHËNAT E MIA TRANSFEROHEN JASHTË BASHKIMIT EVROPIAN ?

Të dhënat tuaja nuk transferohen jashtë Bashkimit Evropian.

### 6. PËR SA KOHË RUHEN TË DHËNAT E MIA ?

Titullari i të dhënave do të ruaj të dhënat tuaja për aq kohë sa do të jetë e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin po trajtohen. Në rastin specifik do të përdoren afatet që janë të parashikuara për arkivimin. Në fund të afatit Titullari do ti eliminoj në mënyrë përfundimtare ose do ti ruaj në formë anonime për të mos lejuar identifikimin me ju në asnjë mënyrë.

### 7. DO TË PROFILIZOHEM?

Të dhënat nuk do të përdoren në asnjë rast për të njohur parapëlqimet dhe sjelljet tuaja dhe ju nuk do ti nënshtroheni asnjë vendimi të bazuar vetëm mbi trajtimin automatik të të dhënave tuaja personale.

### 8. CILAT JANË TË DREJTAT E MIA ?

Ju keni të drejtat e mëposhtme :

- **Të drejtën për ti konsultuar sa herë dëshironi:** mund të kërkonti konfirmim nga Titullari nëse aktualisht janë në përdorim të dhënat tuaja që ju përkasin dhe në këtë rast të merrni informacione në lidhje me përdorimin që po bëhet;
- **Të drejtën e retifikimit:** mund të kërkonti retifikimin e të dhënave personale të pa sakta, vonesa nuk duhet të jetë e pajustificueshme, duke ofruar informacione të mëtejshme nëse dëshironi.
- **Të drejtën për fshirjen e të dhënave:** titullari i të dhënave duhet të fshijë të dhënat personale nëse paraqiten një nga arsyet e mëposhtme:
  - të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur ose përdorur;
  - Ju kundërshtoni trajtimin dhe nuk ekziston asnjë arsye e ligjshme për kryerjen e trajtimit;
  - të dhënat personale janë përdorur në mënyrë të paligjshme;

- të dhënat personale duhet të fshihen për të zbatuar një detyrim ligjor që ka për subjekt Titullarin e të dhënave tuaja.
  - **Të drejtën për kufizimin e trajtimit** : mund ti kërkonit Titullarit kufizimin e trajtimit kur gjendeni përballë hipotezave të mëposhtme:
    - Kundërshtoni saktësinë e të dhënave personale, derisa Titullari të verifikojë të dhënati;
    - Trajtimi është i paligjshëm, si rrjedhim ju kundërshtoni fshirjen e të dhënave dhe kërkonit që përdorimi të jetë i kufizuar;
    - Edhe pse Titullari nuk ka më nevojë për të dhënat në funksion të trajnimit, të dhënat personale ju nevojiten ju për verifikim, për ushtrimin ose mbrojtjen e një të drejte nga ana ligjore;
    - Keni kundërshtuar përdorimin e të dhënave në pritje të verifikimit të epërsisë ligjore të arsyeve të përdoruesit të trajtimit kundrejt arsyeve të interesuarit.
  - **Të drejtën për kundërshtim** : mund të kundërshtoni përdorimin e të dhënave kryer për një akt me interes publik ose lidhur me ushtrimin e fuqisë publike ose mbi interesin e Titullarit apo palëve te treta, ashtu si edhe përdorimin e të dhënave me qëllime marketingu direkte përfshirë profilizimin kur është i lidhur direkt me marketingun .
  - Të drejtën për të mos ju nënshtuar **një vendimi të bazuar vetëm mbi trajtimin automatik**, përfshirë edhe profilizimin, që mund të ketë efekte juridike për ju ose mund të ketë pasoja analoge të rëndësishme për personin tuaj.
- Mund të ushtroni të drejtat tuaja duke dërguar një kërkesë në adresën e-mail të Titullarit [privacy@irst.emr.it](mailto:privacy@irst.emr.it). Titullari do t'ju përgjigjet sa më parë të mundet dhe jo më vonë se brenda 30 ditëve.

#### 9. JAM I DETYRUAR TË JAP TË DHËNAT E MIA ?

Trajtimi i të dhënave tuaja është i domosdoshëm për kryerjen e shërbimit shëndetsor dhe nëse refuzoni mund të lindin vështirësi serioze për t'ju ofruar asistencë mjeksore, përveç rasteve urgjente të parashikuara me ligj.

#### 10. SI MUND TË PARAQES ANKESË?

Nëse dëshironi të paraqisni ankesë për sa i përket mënyrës së trajtimit nga ana e Përdoruesit, pas një ankese që ju i kishit paraqitur, mund të paraqisni instancë direkt Autoritetit të kontrollit sipas mënyrave që gjeni tek faqja [www.garanteprivacy.it](http://www.garanteprivacy.it).

Firma (titullari)  
F.to Giorgio Martelli

(Vendi dhe data ) \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_  
m.

Firma mbasi e keni lexuar (i interesuari) \_\_\_\_\_